



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 430/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugën publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1750 (njëmijë e shtatqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 02.11.2013, në ora 14:00 në afersi të Furra e Qerimiti I dhe shkollës Ismail Qemajli në Prishtin Bregu i Diellit, aktivistët e LVV kan vrejtur se antarë të subjektit politik PDK-së kanë vendosur Banerë të kandidatit për kryetar Komune të Prishtinës Agim Qeku mbi Rrugë publike, dhe poashtu ky poster është vendosur në këtë datë duke ditur se është heshtje zgjedhor. Andaj veprimi i till i vendosjes së banerve mbi rrugë publike është në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 pika b të LZP-së, si dhe dispozitat e nenit 3.4 të Rregullores 11/2013 të KQZ-së. Ndersa shkelja tjetër e këtij subjekti është vendosja e materialit zgjedhor në periudhen e heshtjes zgjedhore siq është parapar në nenin 7 pika b) e Rr.Z. 11/2013 dhe neni 36 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 03.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.11.2013, brenda afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet sipas të dhënave që kemi nga tereni, persona të panjohër kanë bërë një veprim të tillë dhe menjëherë është intervenuar dhe është hequr baneri i kandidatit për kryetar të Prishtinës nga rradhët e PDK. Sipas përgjigjes në ankesë nga subjekti politik PDK kemi indicje se rastet e tilla nga

individ të caktuar që nuk janë antarë të PDK-së po i keqëshfrytojnë simbolet, duke i vendosur ato në vende të palejuara më qëllim për ta dëmtuar PDK-në.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes identifikohet qart se baneri i kandidatit të AAK-së për kryetar të Komunës në Prishtinë është i vendosur mbi rrugë publike siç pretendohet në ankesën me të cilin veprim subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se banerin e kandidatit për kryetar komune në Prishtinë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e banerit. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerin e kandidatit për kryetar të komunës të PDK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

Anr. 430/2013 më datën 04.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*